

PROMOVIMI I TRASHËGIMISË KULTURORE SHQIPTARE NË GJUHË TË HUAJ DHE DOMOSDOSHMERIA E FORMIMIT GJUHËSOR TË SPECIALISTËVE TË FUSHËS

Dr. ATERDA LIKA

Universiteti "Luigj Gurakuqi"
aterda.lika@unishk.edu.al

Prof. asoc. Dr. DHURATA HOXHA

Universiteti "Luigj Gurakuqi"
dhurata.hoxha@unishk.edu.al

ABSTRACT

The cultural and historical heritage is a reflection of the values and cultural level of our people. The task of each of us is to recognize and honor our past, tradition, roots and traces through the centuries through historical memory. At the meeting point of the local and the global, the management of the Albanian heritage, which is already part of the world heritage, pushes us to think globally and act locally to be more careful in our approach to the national cultural heritage. Our contribution as professors of foreign languages in the promotion of our cultural heritage is to train young people capable of giving voice to this heritage in order to make it as accessible as possible to people who are interested in knowing Albania and its heritage. This paper trigger by a recently encountered problem related to the lack of promotional materials in different languages. We have found that most of the materials that serve as guides for tourists visiting Albania are only available in English. Based on the promotion of plurilingualism today, as well as the fact that languages are in themselves a valuable heritage, we believe that the provision of services in other languages, specifically Italian and French, would significantly improve the offer of tourist services by influencing in increasing the number of tourists curious about our heritage.

Keywords: promotion of heritage, foreign languages, promotional materials, tourisme

Trashëgimia historike e kulturore përbën një nga thesaret më të çmuara të historisë dhe artit në Shqipëri e njëkohësisht është pasqyrë e vlerave dhe e nivelit kulturor të popullit tonë. Është detyrë e çdo qytetari të ndërgjegjshëm dhe aq më tepër të aktorëve të këtyre fushave, që nëpërmjet kujtesës historike, të njohin e të nderojnë të kaluarën, traditën, rrënjët e gjurmët tona ndër shekuj duke projektuar njëkohësisht të ardhmen. Për këtë arsye “ruajtja, mbrojtja si dhe rehabilitimi i elementëve që përbëjnë trashëgiminë tonë kulturore”¹ përbën një ndër qëllimet dhe objektivat specifike të Strategjisë Kombëtare për kulturën për vitet 2019-2025.

Me kënaqësi vërejmë se Shqipëria po bëhet tejet tërheqëse për vizitorin e huaj, për historinë e jashtëzakonshme, për pasuritë natyrore mbresëlënëse, për ndërthurjen e bashkëjetesën e kulturave, prandaj ngritja e standardeve të promovimit të trashëgimisë sonë duhet të jetë një prioritet.

Si pedagogë të gjuhëve të huaja, kontributi ynë në promovimin e trashëgimisë tonë kulturore është formimi i të rinjve të aftë për t'i dhënë zë kësaj trashëgimie dhe për ta bërë sa më të aksesueshme për personat që janë të interesuar të njohin Shqipërinë e trashëgiminë e saj.

Ky punim merr shkas nga një problematikë që lidhet me mungesën e materialeve promovuese në gjuhë të ndryshme. Kemi konstatuar se pothuajse të gjitha materialet me fokus trashëgiminë historike e kulturore që shërbejnë edhe si udhërrëfyes për turistët të cilët vizitojnë Shqipërinë, ofrohen vetëm në gjuhën angleze.

Konteksti i këtij konstatimi

Hulumtimi ynë është kryer në kuadër të një projekti të departamentit të Romanistikës për hapjen e një programi të ri “ Bachelor në Gjuhë të Huaja të Aplikuara për Turizmin”, financuar nga Agjensia Universitare e Frankofonisë dhe në bashkëpunim me universitetin Haute-Alsace Francë.

Ai përfshin zonën e Shkodrës dhe atraksionet turistike rreth saj, pasi në pikëtakimin e lokales dhe globales, menaxhimi i trashëgimisë

¹ <https://kultura.gov.al/programi-i-kultures-2019-2025/>

shqiptare që tashmë bën pjesë në atë botërore, na shtyn të mendojmë globalisht dhe të veprojmë lokalisht.

Duke iu referuar pikërisht rajonit tonë, të dhënat janë premtuese për zhvillimin e turizmit. Numri i vizitorëve që kalojnë në pikat kufitare të rajonit të Shkodrës po njih një rritje pak a shumë konstante prej 30% në vit, bazuar edhe në të dhënat që na ofron INSTAT, ku theksohet se përgjatë 7-mujorit të kaluar kanë hyrë në vend mbi 3.9 milionë vizitorë të huaj, 40% më shumë se e njëjta periudhë e vitit paraardhës.² Duke marrë në konsideratë të dhënat e Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore Shkodër, shifra e vizitorëve vetëm në Kalanë e Shkodrës për periudhën janar-nëntor 2022 arriti në mbi 92 mijë³ vizitorë. Një pjesë e mirë e këtyre turistëve janë pjesë e paketave turistike të Kroacisë dhe Malit të Zi, kryesisht vizitorë një ditorë, me kombësi franceze apo italiane, e justifikueshme për afërsinë gjeografike dhe aksesin e lehtë. Zgjatja e kohë-qëndrimit të tyre në Shkodër është një nga sfidat më të rëndësishme me të cilën përballet sot turizmi në rajon. Gjithashtu vihet re edhe një tendencë rritjeje e numrit të vizitorëve që vijnë në Shkodër me ture të vetë-organizuar (me motorë, biçikleta, campers etj). Koha e qëndrimit të tyre është më e gjatë, për vetë natyrën e organizimit dhe të udhëtimit, por përmirësimi i informacionit, i promocionit dhe i shërbimeve për to do të rriste me siguri kohën e qëndrimit.⁴

Gjatë punës tonë hulumtuese, në institucione të ndryshme të trashëgimisë kulturore të qarkut Shkodër, konstatohet një mungesë e materialeve promovuese në gjuhë të ndryshme. Nga të gjitha materialet e marra në shqyrtim kemi konstatuar që në 90% të rasteve guidat ofrohen në gjuhën shqipe dhe atë angleze si psh. materiali divulgativ me titull “Guida Turistike Bashkia Shkodër” ofruar nga Bashkia Shkodër, jep informacion për historinë, pozitën gjeografike, kulturën, traditat si dhe monumentet që duhen vizituar. Gjithashtu materiale të tjera që ofrohen për blerje në zyrën e informacionit për turistët në qendër të qytetit si harta apo guida për qytetin janë gjithashtu në gjuhën angleze me përjashtim të një fletëpalosjeje me titull “Shkodra City map & travel guide”, e cila ofrohet në anglisht, gjermanisht, italisht dhe në gjuhën malazeze.

² <http://www.instat.gov.al/al/temat/industria-tregtia-dhe-sh%C3%ABrbimet/turizmi/>

³ <https://albanian.cri.cn/2022/12/05/ARTIbTFPFm0yeKPihzGs4zAI221205.shtml>

⁴ <https://qarkushkoder.gov.al/tendencat-e-zhvillimit-t-e-turizmit-ne-shkoder/>

Në rrjetin muzeal të qytetit duke filluar me Muzeun Historik të Shkodrës, Muzeun e Kalasë Rozafa, Muzeun e Dëshmisë dhe Kujtesës dhe Muzeun Kombëtar të Fotografisë Marubi kemi konstatuar se mungojnë plotësisht materialet shumëgjuhëshe, përfshirë këtu edhe audioguidat të cilat janë vetëm në gjuhën angleze. Në Muzeun Kombëtar të Fotografisë Marubi vetëm një dokumentar i shkurtër mbi muzeun, që paraqitet në ekran, shfaqet sipas zgjedhjes në gjuhën shqipe, angleze ose italiane. Personeli i këtyre institucioneve shprehet se shpeshherë përballen me kërkesa të vizitorëve, kryesisht persona të moshës së tretë, për shërbime në gjuhë të tjera kryesisht frëngjisht dhe italisht, për arsye që i përmendëm më lart.

Vlen për t’u përmendur fakti se punonjësit e këtyre institucioneve duke qenë njohës edhe të gjuhëve të tjera përveç anglishtes, shprehen se shumë herë e gjejnë veten edhe në rolin e përkthyesve për grupe të ndyshme të organizuara apo edhe individë që zgjedhin të bëjnë shëtitje kulturore në mënyrë të pavarur.

Në aktivitetet e organizuara nga këta institucione, për përmbushjen e qëllimeve të tyre në fushën e përkthimit, shpeshherë kërkojnë bashkëpunimin me përkthyes të çerti-fikuar dhe profesorë të gjuhëve përkatëse të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja në Shkodër.

Bazuar në:

- politikën tonë arsimore gjuhësore sipas së cilës “Shqipëria është plotësisht e vetëdijshme për rëndësinë e gjuhëve në zhvillimin në të ardhmen, prandaj është e angazhuar fuqishëm në zgjerimin e kapaciteteve kombëtare”,⁵
- në promovimin që i bëhet sot plurilinguizmit si “aftësia për të përdorur gjuhët për qëllimet e komunikimit si edhe për të marrë pjesë në bashkëveprime ndërkulturore”,⁶
- si dhe nisur nga fakti që edhe gjuhët janë në vetvete një trashëgimi me vlerë gjykojmë, se ofrimi i shërbimeve edhe në gjuhë të tjera konkretisht italiane dhe frënge me qëllim promovimin sa më të gjërë të trashëgimisë sonë rajonale dhe kombëtare do të përmirësonte në mënyrë të ndjeshme këtë ofertë duke ndikuar në rritjen e numrit të turistëve kureshtarë për trashëgiminë tonë.

⁵ <http://www.arsimi.gov.al>, Profili i Politikës Arsimore Gjuhësore Shqipëria, fq 32

⁶ Kuadri i Përbashkët European i Referencës për Gjuhët, fq 12

Shembuj pozitivë

Departamenti i Romanistikës në Fakultetin e Gjuhëve të Huaja, Shkodër kontribuon në promovimin e trashëgimisë kulturore të vendit tonë apo marrëdhënieve midis kulturave të ndryshme duke ngjall interes dhe bërë jehonë në media dhe në komunitet.

Vlen për t'u përmendur një cikël aktivitete të organizuara në kuadër të vitit të trashëgimisë kulturore 2018 me fokus trashëgiminë dhe ndërkulturorin. Ky cikël ishte konceptuar në katër aktivitete të ndryshme të menduara si katër udhëtime nëpër trashëgimi sipas tematikave të veçanta. Udhëtimi i parë "Vend ku shkon, bukuri që gjen" bën një excursus të bukurive natyrore që përfaqësojnë Francën, Italinë dhe vendet gjermanisht folëse. Udhëtimi i dytë "Vendi ku shkon, personazhe që gjen" sjell në vëmendje figura të shquara të fushave të ndryshme që kanë lënë gjurmë në historinë dhe kulturën e këtyre vendeve. Udhëtimi i tretë "Vend e kuvend" tregon për rite, zakone, festa e simbole që bëjnë pjesë në trashëgiminë kulturore të këtyre popujve duke e bërë gjithnjë e më interesante dhe të pëlqyeshme takimin mes traditës dhe modernes. Udhëtimi i katërt "Vende ku shkon, gatime që shijon", i konceptuar si një udhërrëfyes për njohjen e specialiteteve kulinare të këtyre vendeve, ftoi pjesëmarrësit në aktivitete të bëhen edhe degustatorë të ushqimeve karakteristike të përgatitura me këtë rast.

Po kështu, konkursi i përgatitur nga vetë studentët "Croissant apo Cornetto" në dhjetor 2021 ishte si një garë midis dy kuzhinave më të njohura në botë, asaj italiane dhe asaj franceze, me qëllim që të paraqitej kultura e miqësisë apo rivalitetit, ngjashmëritë apo dallimet midis vlerave dhe traditave kulinare të dy vendeve.

Projekti "Gjuhë të Huaja të Aplikuara për Turizmin"⁷

Refleksionet e parashtruara më sipër, na kanë orientuar drejt alternativave ambicioze për një formim pluridisiplinar të specialistëve të ardhshëm të gjuhëve të huaja, konkretisht hartimin e një projekti për hapjen

⁷ <https://unishk.edu.al/kerkimi-shkencor/projekte/gjuhe-te-huaja-te-aplikuara>

e nje programi të ri studimi “Bachelor në Gjuhë të Huaja të Aplikuara për Turizmin” mbështetur nga Agjensia Universitare Frankofone (AUF) në bashkëpunim me universitetin Haute-Alsace, Francë.

Ky projekt është hartuar:

1. Për plotësimin e një prioriteti strategjik dhe një nevoje pothuajse organike të Fakultetit të Gjuhëve të Huaja në Universitetin e Shkodrës, për të përmirësuar ofertën e programet ekzistuese të gjuhëve të huaja, duke patur parasysh rënien e numrit të studentëve gjatë viteve të fundit, duke propozuar një program pluridisiplinar të ri në sistemin universitar shqiptar, bazuar në përvojën evropiane shumëvjeçare të universiteteve evropiane partnere të USH-së.

2. Si një domosdoshmëri për të përshtatur programet mësimore sipas kërkesave gjithnjë e në rritje të të rinjve shqiptarë për formime pluridisiplinare.

3. Në vijimësi të zbatimit të vendimeve të MASR-së, strategjisë kombëtare për zhvillimin e arsimit parauniversitar, në të cilën saktësohet mësimdhënia e gjuhës frënge si gjuhë e parë në arsimin e mesëm të ulët dhe të lartë, si dhe mësimdhënia e një gjuhë të huaj të dytë (italisht, gjermanisht) në arsimin e mesëm të ulët dhe të lartë, si dhe në shkollat e mesme të gjuhëve të huaja.

4. Për të plotësuar një sërë nevojash të tregut të punës që kanë lidhje me përdorimin e gjuhëve të specialitetit (turizmit në këtë rast), në një moment kur turizmi është një përparësi për vendin tonë dhe mungojnë specialistë të mirëfilltë me njohuri shumë dimensionale.

5. Për të promovuar turizmin dhe trashëgiminë kulturore të rajonit verior.

6. Për të zgjeruar bashkëpunimin me universitetet franceze dhe ato evropiane.

7. Për të përfituar nga përvoja franceze dhe evropiane në lidhje me formimet universitare të orientuara drejt profesioneve.

Risitë e këtij programi:

1. Formim pluridisiplinar, ku ndër të tjera propozohen disiplina mbi trashëgiminë historike, natyrore, kulturore shqiptare të ndërthurura me ato evropiane.

2. Mundësi për të qenë më konkurentë në tregun e punës duke zotëruar në të njëjtat dimensionë dy ose tre gjuhë.

3. Zgjerim i ofertës së formimeve universitare në fushën e përkthimit (sektori ekonomi, turizëm).

4. Shërbesë ndaj komunitetit në tërësi në gjithë zonën e Veriut të Shqipërisë dhe zonave ndërkufitare me të, si në Malin e Zi, në të cilin vihet re një mospërputhje mes kërkesës dhe ofertës, kryesisht në kapacitetet njerëzore, apo Kosovë.

5. Njohje nga afër e mjedisit profesional nga ana e studentëve nëpërmjet praktikës profesionale e parashikuar në vitin e tretë.

6. Integrim më i shpejtë në tregun e punës me kosto jo shumë të lartë shkollimi. Kjo falë një politike të bashkëpunimit me ndërmarrjet të cilat marrin përsipër praktikën profesionale të studentëve dhe punësimin e tyre.

7. Intensifikim i marëdhënieve të universitetit me botën e biznesit duke zhvilluar një metodologji të përhershme bashkëpunimi, për të cilën kemi shumë nevojë.

Në kuadër të zhvillimit të projektit janë zhvilluar seminare të ndryshme formimi në lidhje me sfidat e formimeve universitare në bashkëpunim me mjedisin profesional, mbi zhvillimin e kulturës së bashkëpunimit midis universitetit dhe botës së biznesit, njohjen e terrenit të fushës së turizmit ku këta studentë mund të jenë profesionistë në të ardhmen, mbi zanatet e reja të lindura si pasojë e zhvillimit të turizmit.

Përfundime dhe rekomandime

Jemi të mendimit se një formim pluridisiplinar e shumëgjuhësh është mjaft i rëndësishëm për të gjitha profesionet që kanë të bëjnë me trashëgiminë historike e kulturore dhe turizmin në veçanti. Ndër të tjera vërejmë se figura e guidës turistike ka filluar të profesionalizohet, por mendojmë që duhet plotësuar formimi, në mënyrë që të mos shihet thjesht si një drejtues grupi, por si një figurë komplekse ku ndërthuren elemente, si lidhshipi, interpretimi, ndërmjetësimi, e kultura. Ai duhet konsideruar si një ambasador kulturor, sepse luan një rol të

rëndësishëm në përmirësimin e imazhit të Shqipërisë, si destinacion turistik.

Vlerësojmë si domosdoshmëri formimin e profesionistëve në fushën e ndërmjetësitimit ndërkulturor, të aftë të përballojnë problematika të ndryshme të marrëdhënieve ndërkulturore, gjatë ushtrimit të misionit të tyre: promovimit të trashëgimisë dhe vlerave kulturore.

Universiteti i Shkodrës dhe konkretisht Fakulteti i Gjuhëve të Huaja ka të gjitha kapacitetet të jetë promotor dhe kontribues në promovimin e trashëgimisë kulturore duke formuar specialistë shumëgjuhësh me aftësi ndërmjetësimi dhe interpretimi në kontekste të ndryshme gjuhësore e kulturore.

Meqenëse gjuha e huaj ofrohet në vitin e parë në të gjitha programet e studimit që ofron universiteti ynë dhe shpesh studentët për lehtësi janë të prirur drejt përzgjedhjes së anglishtes, me të cilën janë më të familjarizuar nga ciklet e mëparshme të studimit, ne do të propozonim edhe një shtim të orëve të gjuhëve të tjera për qëllime specifike, me qëllim arritjen e një kompetence shumëgjuhëshe në sektorin ku ata janë të projektuar.

BIBLIOGRAFIA

Këshilli i Evropës. (2002),
Kuadri i Përbashkët Europian i Referencës për Gjuhët, Filara.

Sitografia

<https://www.bashkiashkoder.gov.al>
<http://www.instat.gov.al>
<https://www.albanian.cri.cn>
<https://qarkushkoder.gov.al>
<http://www.arsimi.gov.al>
<https://www.unishk.edu.al>